

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MBLEDHJE BORDI

Gjatë muajit dhjetor Bordi i ERE-s ka zhvilluar 5 mbledhje, të cilat kanë rezultuar në 29 vendimmarrje, ndër të cilat licencimin e 2 subjekteve në prodhimin e energjisë elektrike ngaburime ujore, me një sasi të shtuar energjie totale prej 11,200kW; licencimin e një subjekti në furnizim dhe tregtim të energjisë elektrike; si dhe përcaktimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2023 prej 17.26 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Ndër të tjera, disa vendime të cilat mund të përmendim janë:

1.Miratimin e NEMO (ALPEX sh.a.) në rolin e “Agjentit të Transferimit”, për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës.

2.Shtyrjen e fuqisë juridike për vitin 2024 të vendim të Bordit të ERE-s sipas të cilit janë miratuar tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, si vijon:

- ✓për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35kV - 1.55 Lekë/ kWh;
- ✓ për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.6 - 20 kV - 3.99 Lekë/ kWh;
- ✓ për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4kV - 6.42 Lekë/ kWh;
- ✓Çmimin e aplikueshëm për faturimin e energjisë reaktive prej 1.92 lek/ kWh

3.Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.04.2022, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a., për vitin 2024, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të bordit të ERE-s për vitin

2024, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi prej 10 Lekë/kWh, për vitin 2024. Nga të dhënat paraprake të përftuara nga faqja e zyrtare e Bursës Hungareze të Energjisë, e cila merret për referencë aktualisht, vërehet se çmimi i deri tanishëm mesatar për periudhën 11 mujore të tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për vitin 2023 rezulton në vlerën 109.39 Euro/MWh, çmim i cili është më i lartë se tavani i përcaktuar i çmimit prej 10 lekë/kWh, si rrjedhojë dhe për vitin që vjen çmimi i blerjes së energjisë nga prodhuesit ekzistues me përparësi të energjisë elektrike të jetë sa më sipër përcaktuar.

5.Monitorimi i të licencuarve në veprimtarinë e prodhimit, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, në lidhje me mbajtjen e llogarive të ndara dhe strukturën aktuale organizative, sipas të cilit subjektet e cituara në vendimmarrje duhet të përmbushin detyrimin për mbajtjen e llogarive të ndara për secilën prej veprimtarive të licencuara brenda datës 31.12.2023, i cili duhet të pasqyrohet në pasqyrat financiare të vitit 2023 që do të depozitohen në ERE brenda afateve të përcaktuara në kushtet përkatëse të licencave.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

SEANCA DËGJIMORE

VENDIME

[KA NISUR PROCEDURA PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR LËSHIMIN, TRANSFERIMIN DHE ANULIMIN E GARANCIVE TË ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E RINOVUESHME”.](#)

[GARANCIA E ORIGJINES \(GO\)”, ËSHTË NJË DOKUMENT ELEKTRONIK, I CILI KA FUNKSION TË VETËM QË T’I PROVOJË KONSUMATORIT FUNDOR SE, NJË PJSË OSE E GJITHË SASIA E ENERGJISË ELEKTRIKE TË PËRDORUR PREJ TIJ ËSHTË PRODHUAR PREJ BURIMEVE TË RINOVUESHME. KLIKO KËTU PËR TË LEXUAR “RREGULLORE PËR LËSHIMIN, TRANSFERIMIN DHE ANULLIMIN E GARANCIVE TË ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E RINOVUESHME.” NË SHQYRTIM NË RUBRIKËN KONSULTIME](#)

[KA NISUR PROCEDURA PËR MIRATIMIN E “METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË DETYRIMIT PËR ENERGJINË E RINOVUESHME PËR T’U PAGUAR NGA KONSUMATORËT FUNDORË TË ENERGJISË ELEKTRIKE” SI DHE KA PËRFUNDUAR PROCEDURA PËR HEQJEN E LICENCAVE TË SUBJEKTEVE DEBITORE PËR PAGESAT E RREGULLIMIT TË VITIT 2023 TË PASHLYERA, DUKE REZULTUAR NË VETËM NJË LICENCË TË HEQUR, ME KËRKESË TË SUBJEKTIT, PAS SHLYERJES SË DETYRIMEVE PËRKATËSE. PËR TU BËRË ME DIJE MBI SUBJEKTET PËRKATËSE, POR DHE VENDIMET E SIPËRCITUARA, JU LUTEMI TË VIZITONI FAQEN TONË ZYRTARE \[WWW.ERE.GOV.AL\]\(http://WWW.ERE.GOV.AL\).](#)

Pjesë e aktivitetit të ERE-s për këtë muaj kanë qënë dhe seancat dëgjimore me subjekte të licencuar si dhe palë interesi, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo përfitim të qëndrimeve të palëve me qëllim një vendimmarrje më të plotë.

Ndër to mund të përmendim 6 seanca dëgjimore të zhvilluara nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me subjekte të licencuara dhe palë të përfshira në proces, të cilat në thelb kanë patur evidentime dhe sqarime të nevojshme për të çuar para procese si rinovim të licencës apo kërkesa të ndryshme, në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si dhe për të diskutuar në lidhje me plotësimin e informacionit të Raportit të Pajtueshmërisë përkatësisht të OSSH sh.a. dhe OST sh.a.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

AKTIVITETE

Në datën 05 dhjetor 2023, MEDREG organizoi Asamblenë Gjenerale në Valletta, Maltë në të cilën mori pjesë dhe ERE-s, si anëtare e hershme e Shoqatës së Rregullatorit të Mesdheut. Gjatë këtij takimi fokus patën avancimet rregullative në sektorin e gazit natyror, energjisë elektrike dhe burimeve të rinovueshme, por dhe tematika të tjera si themelimi i grupit të punës virtual mbi hidrogenin, duke njohur rolin thelbësor të hidrogjenit të gjelbër në dekarbonizimin e sektorëve sfidues; mbështetja për iniciativa që shpejtojnë tranzicionin drejt energjisë së gjelbër; miratimi i masave për të adresuar sigurinë e furnizimit të gazit dhe për të përmirësuar mbrojtjen e konsumatorit; integrimin e matësave dhe rrjetit inteligjent apo dhe rritja e bashkëpunimit të vendeve të rajonit për një qasje të përbashkët ndaj sfidave të energjisë.



MEDREG beson se vendet anëtare ndajnë sfida dhe mundësi të përbashkëta energjetike, duke i bërë ato partnerë të vlefshëm në avancimin e bashkëpunimit rajonal. Duke përfshirë anëtarë të rinj, synohet të krijohet një zë i unifikuar për politikën e qëndrueshme të energjisë, lehtësimi i integritetit të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe të mbështetet kalimin në një ekonomi me karbon të ulët. Ky vizion i përbashkët do të kontribuojë në arritjen e sigurisë rajonale të energjisë, rritjes ekonomike dhe qëndrueshmërisë mjedisore.

Në këtë aktivitet Enti Rregullator i Energjisë u përfaqësua nga Komisionerja znj. Erjola Sadushi e cila gjithashtu relatoi raportin e grupit të punës së konsumatorit të MEDREG, znj. Julia Guga, Drejtore në Drejtorinë e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve si dhe znj. Oriana Kallaku, Drejtore në Drejtorinë e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes.